

STATUTI

KOLEGJI PROFESIONAL I LARTË

“TIRANA ESTHETICS & STYLE SCHOOL” (TESS)

KREU I

PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Të përgjithshme

Kolegji Profesional i Lartë “Tirana Esthetics & Style School” (TESS), e ushtron aktivitetin mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë në RSH” dhe në VKM Nr.370 datë 26.04.2017 “Për organizmin dhe funksionimin e kolegjit profesional të lartë”, në Statutin e këtij Kolegji si edhe në gjithë legjislacionin tjetër në fuqi.

Ky statut përcakton: organizimin, strukturat përbërëse të institucionit, veprimtaritë e autoriteteve dhe organeve drejtuese, zgjedhjen dhe emërimin e tyre, nivelet e delegimit të kompetencave nga autoritetet drejtuese dhe administrative, periudhat e kryerjes së vlerësimit të brendshëm të strukturave ose programeve të studimit, të drejtat dhe detyrat e personelit akademik, ndihmës akademik, administrativ dhe studentëve, si dhe çështje të tjera të cilat rregullojnë veprimtarinë e kolegjit profesional të lartë “Tirana Esthetics & Style School”, si institucion jopublik i arsimit të lartë, i cili ofron programe studimi të larta me karakter profesional, pas arsimit të mesëm.

Neni 2

Rregulloja e Kolegjit

Rregullorja i bashkëngjitet Statutit të Kolegjit Profesional të Lartë “Tirana Esthetics & Style School”; ajo e shtrin veprimin e saj mbi të gjithë njësitë përbërëse dhe personelin e këtij kolegji.

Neni 3

Misioni dhe vizioni



Kolegji Profesional i Lartë "Tirana Esthetics & Style School" vepron në fushën e arsimit të orientuar profesional dhe përgatit profesionistë me aftësi praktike. Në gjithë veprimtarinë e tij, ka për mision:

- a) Të realizojë arsimimin profesional, nëpërmjet mësimdhënies dhe praktikës profesionale në fushat që mbulon;
- b) Të kryejë veprimtari praktike në fushat që mbulon dhe t'i përdorë ato në favor të veprimtarisë akademike.
- c) Të përgatisë profesionistë me aftësi praktike

Vizioni i TESS është të jemi edukuesit më të admiruar në fushën e kozmetologjisë, estetikës, mirëqënies dhe biznesit të bukurisë duke e ngritur në një nivel të ri standartin e edukimit profesional në Shqipëri.

Neni 4

Adresa e ushtrimit të veprimtarisë

Kolegji Profesional i Lartë "Tirana Esthetics & Style School" ushtron aktivitetin e saj në adresën : Rruga "Gjeneral Nikols" pallati Shushica, kati i parë, Tiranë, Shqipëri.

Neni 5

Liria dhe autonomia akademike

Ligji i Arsimit të Lartë njeh Kolegjin Profesional të Lartë "Tirana Esthetics & Style School", si institucion autonom dhe i jep liri akademike në mësimdhënie. Liria akademike në mësimdhënie nënkupton respektimin e shumëllojshmërisë së opinioneve, ideve, metodave dhe garantimin e zhvillimit të lirë, kritik e krijes të mësimdhënies. Kjo liri akademike ushtrohet në përputhje me planet e programet mësimore të hartuara e miratuara nga instancat përkatëse të Kolegjit Profesional të Lartë "Tirana Esthetics & Style School", për të gjitha kurset e studimeve.

Në bazë të autonomisë, Kolegjit Profesional të Lartë "Tirana Esthetic & Style School", i njihet e drejta e:

- zgjedhjes së organeve drejtuese të tij në shkallë institucioni e në departamente;
- emërimeve të autoriteteve të veta sipas Rregullores dhe këtij Statuti;
- miratimit të rregullores së brendshme;
- përcakimit të fushave të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor;
- miratimit të planeve e programeve mësimore;
- administrimit të buxhetit të vet sipas Rregullores së Brendshme;
- vendosjes së marrëdhënieve me shkollat të tjera të larta të vendit e të huaja për shkëmbim përvoja dhe për bashkëpunim në procesin mësimor për kualifikim, etj.;
- anëtarësimit në shoqata e organizata kombëtare e ndërkombëtare të Arsimit të Lartë;

- bashkëpunimit me fondacione vendase e të huaja që ndihmojnë në zhvillimin e Arsimit të Lartë;
- pranimi dhe përcaktimi të modaliteteve të pranimi të studentëve të rinj;
- përzgjedhjes së personelit akademik dhe joakademik;
- ofrimit të shërbimeve në fushat që kanë lidhje me aspektet e zbatimit praktik të mësimdhënies dhe realizimit të të ardhurave prej tyre;
- përdorimit të tokës, ndërtesave dhe pasurive të tjera që zoteron apo ka në qeramarrje;
- zotërimit të çdo lloj pasurie tjetër sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 6

Të drejtat e Kolegjit Profesional të Lartë "Tirana Esthetics & Style School"

Në zbatim të autonomisë institucionale dhe lirisë akademike Kolegji Profesional i Lartë "Tirana Esthetics & Style School" ,ka të drejtë:

- a. Të zgjedhë lirisht programet e studimit që do të ofrojë përkundrejt plotësimit të kërkesave ligjore dhe standardeve akademike;
- b. Të miratojë plane, programe mësimore, tekste në përdorim të studentëve të tij, si dhe literaturën përkatëse në përputhje me standardet ligjore në fuqi;
- c. Të përcaktojë, nëse e sheh të arsyeshme, kritere të veçanta për çdo program studimi, si kusht për pranimin e studentëve në to, si edhe të përcaktojë procedurat dhe kriteret për dhënie bursave të studimit.
- d. Të zgjedhë lirisht strukturën institucionale të Kolegjit Profesional të Lartë "Tirana Esthetics & Style School" "Tirana Esthetic & Style School", autoritetet dhe organet e veta drejtuese sipas këtij Statuti dhe legjislacionit në fuqi;
- e. Të përzgjedhë personelin akademik, personelin ndihmës akademik dhe personelin administrativ, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.
- f. Të krijojë lidhje/ura bashkëpunimi me struktura të institucioneve (të ngjashme ose të përafërta) të arsimit të lartë dhe/ose të trainimit profesional brenda ose jashtë vendit, që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e arsimit të lartë;
- g. Të anëtarësohet në shoqata e organizata kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë publik dhe/ose jopublik;
- h. Të ofrojë shërbime në fushat që kanë lidhje me aspektet e zbatimit praktik të mësimdhënies në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe këtë Statut;
- i. Të pranojë donacione nga fondacione vendase e të huaja që ndihmojnë zhvillimin e Arsimit të Lartë;
- j. Të përdorë tokën, ndërtesat dhe pasuritë e tjera që zotëron ose që ka në posedim për qëllime të arsimit ose që lidhen me të;
- k. Të zotërojë çdo lloj pasurie tjetër sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 7 Paprekshmëria

Shteti garanton paprekshmërinë e institucioneve të Arsimit të Lartë, përfshi edhe Kolegjin Profesional të Lartë "Tirana Esthetics & Style School" dhe territorit të tyre. Ndërhyrja në mjediset e kolegjit të personave fizikë apo juridike, privatë e shtetëror, të pushtetit qëndror e lokal si dhe ajo e organeve të rendit publik bëhet me kërkesën ose me lejen e Rektorit, apo të personit të autorizuar prej tij. Vetëm në rastet e kryerjes së një krimi flagrant dhe në rastet e një fatkeqësie natyrore, organet e rendit publik ndërhyjnë edhe pa lejen e titullarit. Cënimi i paprekshmërisë së institucioneve të Arsimit të Lartë ndëshkohet sipas dispozitave ligjore.

Neni 8 Detyrimet e Kolegjit Profesional të Lartë "Tirana Esthetics & Style School"

Kolegji Profesional i Lartë "Tirana Esthetics & Style School", ka për detyrë:

- Të zhvillojë procesin akademik e të kualifikimit profesional sipas standardeve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe në përputhje me normat dhe standardet e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë të vendeve që bëjnë pjesë në Organizatën për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD);
- Të respektojë angazhimet e ndërmarra prej tij që burojnë nga kontratat me studentët, personelin e tij, ose me palë të treta;
- Të raportojë në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për veprimtarinë e tij mësimore - akademike, sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore;
- T'i nënshtrohet vlerësimit dhe akreditimit periodik të programeve të studimit dhe atij institucional;
- Të bëjë publike programet e licencuara të studimit që ofron si edhe statusin e akreditimit të tyre;
- Të bëjë të njohur publikisht raportet e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë, si dhe nëse programet e studimit që ofron janë të akredituara në respektim të kushteve dhe afateve ligjore.

Neni 9 Përfaqësimi dhe përgjegjësia ligjore

Kolegj Profesional i Lartë, "Tirana Esthetics & Style School", përfaqësohet sipas rastit nga Administratori dhe/ose Rektori. Përfaqësimi i Kolegjit Profesional të Lartë "Tirana Esthetics & Style School" për çështjet akademike dhe protokollare bëhet nga Rektori i kurse për çështjet administrative dhe financiare përfaqësohet nga Administratori i Kolegjit.

Personi juridik "NLT" ShPK është përgjegjës për të gjithë veprimtarinë, administrimin dhe financimin e institucionit.



KREU II

STRUKTURA ORGANIZATIVE AKADEMIKE DHE ADMINISTRATIVE E KOLEGJIT PROFESIONAL TË LARTË "TIRANA ESTHETIC & STYLE SCHOOL"

Neni 10

Struktura organizative

1. Kolegji Profesional "Tirana Esthetics & Style School", ka këtë strukturë Akademike:
 - Senati Akademik;
 - Rektori;
 - Rektorati;
 - Asambleja e personelit akademik;
 - Këshilli i Etikës;
 - Këshilltari akademik i studentëve;
 - Departementet;
 - Drejtuesi i Departamentit;
 - Njësitë ndihmëse;
2. Kolegji Profesional "Tirana Esthetics & Style School", ka këtë strukturë Administrative:
 - Bordi i Administrimit;
 - Administratori;
 - Strukturat administrative;
3. Struktura akademike dhe administrative, është sipas shtojcës 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij statuti.

Neni 11

Senati akademik

1. Senati akademik i institucionit të arsimit të lartë është përgjegjës për përmbushjen e misionit të tij.
2. Senati kryesohet nga rektori dhe mbledhet periodikisht.
3. Senati Akademik i Kolegjit Profesional të Lartë "Tirana Esthetic & Style School" përbëhet nga jo më pak se pesë anëtarë.

4. Anëtarët e senatit në i përkasin kategorisë “Profesor” ose kanë gradën shkencore “Doktor” (“PHD”), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së, në mungesë të autoriteteve drejtuese me këtë titull dhe, për efekt të përfaqësimit, kategoria e tyre mund të zbresë, sipas përcaktimeve të bëra në statutin e kolegjit. Ata mund të jenë drejtues të lëndëve, drejtues të njësive bazë, drejtues të projekteve studimore, etj Numri i përfaqësimit nga njësitë bazë është i balancuar. Përzgjedhja bëhet mbi bazë të dosjes personale të gjithsecilit si dhe kontributit të tij në mbarëvajtjen e punëve në kolegji.
5. Në Senatin Akademik të Kolegjit Profesional të Lartë “Tirana Esthetics & Style School” merr pjesë dhe një student i zgjedhur nga strukturat studentore.
6. Funksionet kryesore të senatit akademik janë:
 - a) garanton autonominë e institucionit, lirinë akademike, si dhe të drejtat e studentëve;
 - b) propozon planin strategjik të zhvillimit të kolegjit;
 - c) miraton statutin e kolegjit Kolegjit Profesional të Lartë “Tirana Esthetics & Style School” të me dy të tretat e votave të anëtarëve të tij, pasi të jetë marrë miratimi paraprak i Bordit të Administrimit;
 - ç) harton strukturën e përgjithshme të kolegjit dhe i propozon Bordit të Administrimit numrin e personelit të institucionit në të gjitha nivelet;
 - d) miraton rregulloret e institucionit dhe aktet e tjera, sipas përcaktimeve të bëra në statut;
 - dh) miraton programet e reja të studimit, ndryshimet si dhe mbylljen e tyre. Programet e reja të studimit duhet të jenë të mbështetura në projektbuxhetin vjetor të institucionit;
 - e) propozon mbylljen dhe riorganizimin e kolegjit, si dhe ndarjen ose bashkimin e tij lartë me një institucion tjetër të arsimit të lartë;
 - ë) miraton hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive të kolegjit mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore dhe të njësive bazë. Në këto raste merr vlerësimin paraprak të Bordit të Administrimit;
 - f) miraton planin vjetor të veprimtarive akademike;
 - g) miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit, të hartuar nga rektorati, dhe ia përcjell atë ministrisë përgjegjëse për arsimin;
 - gj) zgjedh përfaqësuesit e tij në Bordin e Administrimit;
 - h) miraton paraprakisht planin buxhetor vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit;
 - i) garanton sigurimin e brendshëm të cilësisë në kolegjin profesional të lartë “Tirana Esthetics & Style School”;
 - k) krijon mekanizmat për vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore të personelit akademik;
 - l) organizon mbledhjen e përbashkët, në bashkëpunim me Bordin e Administrimit, në fund të çdo viti akademik, ku diskutohet për veprimtarinë mësimdhënëse dhe atë financiare.

7. Senati mbledhet si rregull ne seanca te zakonshme, se paku 1 (një) herë në 2 (dy) muaj dhe më shpesh kur e thërret rektori. Rendi i ditës propozohet nga kryetari i senatit. Senati miraton rendin e ditës me shumicë të thjeshtë votash.
8. Mbledhjet e senatit quhen të rregullta kur në to janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve; vendimet merren me shumicë të thjeshtë (mbi 50%) të anëtarëve pjesëmarrës.
9. Për marrjen e vendimeve, mirëkuptimi dhe votimi i hapur është procedurë e zakonshme. Mënyra e votimit të fshehtë është e detyrueshme kur kërkohet nga shumica e të pranishmëve. Çdo anëtar e ushtron vetë të drejtën e votës, pa patur të drejtë t'a delegojë atë.

Neni 12 Rektori

1. Rektori është autoriteti më i lartë akademik dhe përfaqësuesi ligjor dhe protokollar i Kolegjit Profesional të Lartë "Tirana Esthetics & Style School", konform legjislacionit në fuqi.
2. Rektori mban titullin e kategorisë "Profesor".
3. Rektori zgjidhet nga Senati mes kandidatëve që vijnë nga radhët e personelit akademik të i Kolegjit Profesional të Lartë "Tirana Esthetics & Style School" ose nga jashtë tij. Kandidatët konkurrojnë me dosje personale.
4. Rektori zgjidhet me shumicën e të gjithë anëtarëve të Senatit Akademik.
6. Mandati i rektorit zgjat katër vjet. Ai shërben në detyrë për një mandat, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Pas përfundimit të mandatit, ai vazhdon të jetë anëtar i personelit të njësisë bazë ku kryen veprimtarinë e tij akademike.
7. Mandati ndërpritet para përfundimit kur rektori:
 - a. Dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
 - b. Jep dorëheqjen;
 - c. Është në pamundësi për të kryer detyrën;
 - d. Janë konstatuar shkelje të rënda të ligjit ose Kodit të Etikës;
 - e. Kur nuk është më pjesë e Kolegjit Profesional të Lartë "Tirana Esthetics & Style School".
8. Procesi i shkarkimit të Rektorit inicohet me kërkesë të jo më pak se 1/5 e anëtarëve të Senatit Akademik. Votimi për shkarkimin e Rektorit bëhet me 3/5 e votave të Senatit.

Neni 13 Funksionet e Rektorit

Funksionet kryesore të Rektorit janë:

- a) Rektori drejton Senatin Akademik dhe raporton para tij;
- b) I paraqet senatit planin strategjik të zhvillimit;

- c) Është anëtar i konferencës së rektorëve;
- d) Ka të drejtën të informohet nga autoritetet drejtuese të të gjitha njësive për vendimet dhe masat e marra prej tyre.
- e) Shfuqizon kryesisht apo me kërkesë të të interesuarit aktet kur ato bien ndesh me kushtetutën, Ligjin Nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë & Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë, statutin, rregulloren dhe legjislacionin tjetër në fuqi.
- f) Nënshkruan, diplomat e përfundimit të studimeve, pa patur të drejtën e delegimit të firmës personave të tjerë.
- g) Rektori nënshkruan kontratat e punës të personelit akademik dhe ndihmës akademik në institucionet e arsimit të lartë;
- h) Jep leje për hyrjen e forcave të rendit në mjediset universitare dhe mund t'i thërrasë ato në rast nevojë.
- i) Ka të drejtën e delegimit të firmës personave të tjerë vartës të tij.
- j) Ngre komisione e grupe për çështje, studime e veprimtari të veçanta.
- k) Emëron përgjegjësit e departamenteve dhe zyrave të nivelit ndihmës akademik.
- l) Zgjidh në mënyrë përfundimtare mosmarrëveshjet me karakter akademik;
- m) Miraton masën disiplinore të përjashtimit të studentëve nga Kolegji për rastet e parashikuara në rregullore dhe Kodin e Etikës.
- n) I kërkon informacion bordit të administrimit për çështje të kompetencës së këtij organi.
- o) Jep dhe miraton masat disiplinore për punonjësit, deri në largimin e tyre nga puna kur shkelen nenet e statutit, të Kodit të Punës dhe Kodit të Etikës.
- p) Miraton promocionet, dekorimet e punonjësve në përputhje me Legjislacionin e Republikës së Shqipërisë;
- q) Lidh dhe zhvillon marrëdhënie kooperimi në fushën akademike me persona dhe institucione brenda dhe jashtë vendit.
- r) Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë & Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqipërisë, kur me veprimet ose mosveprimet e tij, përgjegjësi i departamentit shkel në mënyrë të përsëritur aktet ligjore, nënligjore, statutin, apo rregulloret e institucionit, në rastet e kryerjes së veprave penale flagrante ose të shkeljeve të rënda të ligjit, të pamundësisë për të kryer detyrën dhe për rastet e parashikuara në Kodin e Etikës, rektori shkarkon dekanin dhe përgjegjësin e departamentit.
- s) Zbaton vendimet e Bordit të Administrimit;
- t) Ushtron të gjitha funksionet e tjera të përcaktuara në këtë statut dhe në akte të tjera normative të institucionit.
- u) Ratifikon marrëveshjet e nënshkruara në emër të Kolegjit Profesional të Lartë "Tirana Esthetics & Style" për anëtarësimin e institucionit në organizata kombëtare e ndërkombëtare të Arsimit të Lartë, për bashkëpunim me universitete e shkolla të tjera të larta të vendit e të huaja, marrëveshje



bashkëpunimi me organizma joqeveritare, donatore vendas e të huaj që mund të ndihmojnë në zhvillimin e kolegjit.

Neni 14 Rektorati

1. Rektorati është një organ kolegjal, i cili drejtohet nga Rektori dhe përbëhet nga :
 - a. Rektori
 - b. Administratori i KPL "Tirana Esthetics & Style School"
 - c. Përgjegjësit e departamenteve
2. Funksionet kryesore të Rektoratit janë:
 - a. Harton planin strategjik të zhvillimit të Institucionit;
 - b. Harton programin vjetor të veprimtarive, si dhe ndjek zbatimin e tij pas miratimit në Senatin Akademik.
 - c. Paraqet rekomandime për projektet për programet e studimeve, të praktikave profesionale dhe ndryshimet e nevojshme strukturore për realizimin e tyre.
 - d. I propozon Senatit hapjen, ndryshimin ose mbylljen e departamenteve ose njësive të tjera bazë ose ndihmëse.
 - e. Zbaton të gjitha vendimet e miratuara nga Senati Akademik të cilat i drejtohen atij.
 - f. Monitoron dhe publikon rezultatet e vlerësimit të veprimtarive të institucionit.
 - g. Propozon strukturën e përgjithshme institucionale si dhe kategoritë e personelit akademik që nevojiten sipas niveleve të studimit.
 - h. Shqyrton trajtimin e rasteve përjashtimore, bazuar në kërkesën me shkrim të personit të interesuar. Në çdo rast, vendimi nuk mund të anashkalojë detyrimin për shlyerjen e detyrimeve që garantojnë përmbushjen e standardeve akademike.
 - i. Harton raportin vjetor të veprimtarive mësimore e kurrikulare dhe e paraqesin atë për miratim në Senat.
 - j. Lëshon urdhëra dhe udhëzime për të gjitha strukturat përbërëse të KLP "Tirana Esthetics & Style School"
3. Rektorati si organ kolegjal funksionon me mbledhje. Mbledhja e Rektoratit kryesohet dhe thirret nga Rektori.
4. Organizimi dhe veprimtaria e Rektoratit përcaktohet me Rregullore të veçantë.

Neni 15 Asambleja e Personelit Akademik

1. Asambleja e personelit personeli akademik me kohë të plotë i njësive bazë.

- Tirana Esthetics Style School- Rr."Gjeneral Nikols", "Pallati Shushica" Kati I, Tiranë, Shqipëri.
Tel: + 355 (4) ; Fax: + 355 (4) ; Cel: + 355 69 400 0014;
e-mail: info@tess.al, www.tess.al

- të këshillojë studentin për të gjitha problemet që ai do të ketë gjatë periudhës së studimeve;
- të këshillojë studentin lidhur me vazhdimin e studimeve në nivele të tjera universitare.

Neni 18 **Departamentet**

Departamenti i kolegjit është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe trajtimit, i cili përfshin fusha të përafërta dhe grupon disiplinat mësimore trajnuese të përafërta. Ai është përgjegjës për programet e studimit që ofron.

Departamenti nxit, programon, bashkërendon, organizon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë të trajnimit.

Departamenti përbëhet së paku nga pesë anëtarë të punësuar më kohë të plotë si personel mësimdhënës, nga të cilët të paktën një me gradë shkencore ose titull akademik.

Kolegji profesional i Lartë "Tirana Esthetics & Style School" Ka këto departamente:

- Departamenti i Estetikës dhe Nutricioni;
- Departamenti i Kozmetologjisë;

1.1 Departamenti Estetikës dhe Nutricionit ofron programin profesional jo-universitar 2 vjecar për estetistët i cili synon të krijojë profesionistë në fushën e estetikës.

1.2. Departamenti i Kozmetologjisë ofron programin profesional jo-universitar 1 vjecar për të mundësuar një formim të plotë e gjithë përfshirës për të fituar njohuritë e nevojshme për profesionin e make-up artist, e gjithashtu programin profesional jo-universitar 2 vjecar për Hair Artist.

Brenda cdo departamenteti krijohen seksionet sipas grupimeve të lendeve bazuar në natyrën e ngjashme të tyre. Studiot / Laboratorët e KLP "Tirana Esthetics & Style School" kanë për qëllim të ofrojnë konsulencë teknike dhe të angazhojnë në punë praktike si pedagogët dhe studentët.

Neni 19 **Drejtuesi i Departamentit**

1. Drejtuesi i njësisë bazë është drejtuesi i departamentit. Ai është autoriteti drejtues akademik i asaj njësie dhe e përfaqëson atë. Ai emërohet sipas përcaktimeve në statutin e institucionit.

2. Drejtuesi i Departamentit është personel akademik i kategorisë "Profesor" ose ka gradën shkencore "Doktor" ("PHD"), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së. Në mungesë të autoriteteve drejtuese me këtë titull/gradë

shkencore dhe për efekt të përfaqësimit, kategoria e tyre mund të zbresë, sipas përcaktimeve të bëra në statutin e institucionit.

3. Drejtuesi mund të shërbejë në detyrë për një mandat katërvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Pas përfundimit të mandatit ai vazhdon të jetë anëtar i personelit të njësishë bazë ku kryen veprimtarinë e tij akademike.

4. Funksionet e drejtuesit të njësishë bazë rregullohen në rregulloren e departamentit.

Neni 20 **Njësitë Ndihmëse**

Njësitë ndihmëse konsiderohen laboratorët, bibliotekat dhe mjedise të tjera të cilat shërbejnë për të realizuar studime, praktikë dhe shërbime të ndryshme për të ndihmuar zhvillimin e procesit të të mësimdhënies.

Neni 21 **Bordi i Administrimit**

1. Bordi i Administrimit është organi më i lartë kolegjal administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të institucionit të arsimit të lartë, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij.
2. Bordi i Administrimit të kolegjit përbëhet nga jo më pak se tre anëtarë, të punësuar më kohë të pjesshme, të zgjedhur sipas përcaktimeve në statutin e institucionit.
3. Bordi i Administrimit ka këto funksione kryesore:
 - a) garanton qëndrueshmërinë financiare të kolegjit dhe përmbushjen e misionit të tij;
 - b) me propozim të Senatit Akademik, miraton planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tij;
 - c) me propozim të Senatit Akademik, miraton buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tyre;
 - ç) me propozim të Senatit Akademik, miraton numrin e personelit në të gjitha departamentet;
 - d) vlerëson paraprakisht mbylljen dhe riorganizimin e institucionit, si dhe ndarjen ose bashkimin e tij me një institucion tjetër të arsimit të lartë;
 - dh) miraton paraprakisht hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive përbërëse të kolegjit;
 - e) jep mendim për projekt rregulloren e institucionit dhe miraton rregulloren financiare të tij;
 - ë) përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron institucioni nga ushtrimi i veprimtarive të tij, si dhe mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit;

- f) është përgjegjës për caktimin e kriterëve e të procedurave për punësimin e administratorëve dhe personelit administrativ, mbështetur në aktet e institucionit të arsimit të lartë;
 - g) emëron dhe shkarkon administratorin e institucionit;
 - gj) miraton paraprakisht statutin e institucionit të arsimit të lartë, para se t'i përcillet Senatit Akademik;
 - h) miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit, të hartuar nga rektorati.
4. Veprimtaria e Bordit të Administrimit rregullohet me rregulloren e Brendshme të tij.

Neni 22 **Administratori**

1. Administratori është autoriteti më i lartë administrativ dhe përgjegjës për mirëfunksionimin financiar të institucionit. Ai është përfaqësues ligjor i kolegjit profesional të lartë "Tirana Esthetics & Style School" për çështjet financiare dhe administrative.
2. Administratori emërohet dhe shkarkohet nga Bordi i Administrimit të arsimit të lartë sipas përcaktimeve në statutin e kolegjit. Administratori duhet të ketë arsim të lartë, së paku në nivelin "Master i shkencave" në fushën e drejtësisë ose ekonomisë dhe përvojë pune së paku shtatë vjet në këto fusha. Administratori nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër, akademik apo administrativ.
3. Administratori i raporton për veprimtarinë e tij Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik, sipas përcaktimeve të statutit të institucionit të arsimit të lartë.
4. Funksionet e administratorit janë:
 - a) harton projektbuxhetin vjetor, mbi bazën e propozimeve njëjësive bazë, mbështetur në planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe në planin buxhetor afatmesëm të tij;
 - b) propozon kriteret për administrimin e burimeve financiare dhe materiale, të cilat ia paraqet për miratim Bordit të Administrimit dhe mbikëqyr shpërndarjen e zbatimit të tyre;
 - c) ndjek dhe kontrollon zbatimin e buxhetit vjetor të kolegjit në strukturat e varësisë së tij;
 - ç) zbaton të gjitha vendimet e Bordit të Administrimit dhe të Senatit Akademik me karakter financiar dhe administrativ;
 - d) i paraqet Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik raportin mbi veprimtarinë financiare të institucionit të arsimit të lartë, në përfundim të vitit akademik;
 - e) dh) bashkëpunon me strukturat dhe autoritetet e tjera të institucionit të arsimit të lartë për çështje të administrimit të përditshëm;
 - f) plotëson kërkesat e rektorit, me qëllim përmbushjen e nevojave akademike, administrative dhe financiar.

Neni 23
Struktura administrative

Struktura administrative përfshin seksionet si vijon:

- Sektorin Financë
- Sektorin Sekretari
- Sektorin Bibliotekë / Arkivë
- Sektorin IT dhe pajisje elektronike (ngritja dhe mirembajtja e sistemit të rrjetave të komunikimit të brendshëm, mirembajtja e të gjitha pajisjeve elektronike);
- Sektorin mirëmbajtje dhe shërbime (personeli teknik i mirëmbajtjes së ambienteve, pastrimit, etj)

Kualifikimi dhe eksperiencat që duhet të plotësojë stafi për secilin nga pozicionet e mësipërme do të jepet në manualin e përshkrimit të vendit të punës dhe detyrave të personelit si dhe në kontratën individuale që do të lidhet me secilin prej tyre.

KREU III
ORGANIZIMI I STUDIMEVE

Neni 24
Forma e studimeve në Kolegjin Profesional të Lartë "Tirana Esthetics & Style School"

Në Kolegjin Profesional të Lartë "Tirana Esthetics & Style School", studimet do të ofrohen vetëm në formë me kohë të plotë.

Neni 25
Programet e studimeve

1. Kolegjin Profesional të Lartë "Tirana Esthetics & Style School", ofron programe të akredituara të studimeve të arsimit të lartë me natyrë profesionale, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student me kohë të plotë është 60 kredite.
2. Programet e studimeve hartohen nga Departamentet në përputhje me kërkesat ligjore të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", sipas specifikave të secilit program dhe miratohen në senatin akademik.
3. Kolegji Profesional të Lartë "Tirana Esthetics & Style School", shpall publikisht programet e akredituara të studimeve që ofron para fillimit të aplikimeve për pranimet.

4. Çdo lëndë e programit të studimit zhvillohet në përputhje me programin e vet mësimor. Programi mësimor i lëndës hartohet nga titullari i lëndës në përputhje me kriteret dhe formatin e miratuar nga Rektorati. Programi mësimor i lëndës konsultohet në grupin mësimor përkatës dhe miratohet nga Përgjegjësi i Departamentit.

Neni 26

Ciklet dhe titujt e studimeve

1. Programet e studimeve në Kolegjin Profesional të Lartë "Tirana Esthetics & Style School", organizohen në program të studimeve të studimi me karakter profesional të lartë dhe programe.
2. Kolegji Profesional të Lartë "Tirana Esthetics & Style School", ofron programe studimi me karakter profesional, pas arsimit të mesëm, me 60 ose 120 kredite formimi, referuar nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Kohëzgjatja e tyre normale është një ose dy vite akademike dhe në përfundim lëshohet respektivisht "Certifikatë profesionale" ose "Diplomë profesionale" në fushën e arsimimit të kryer.
3. Kreditet e grumbulluara gjatë studimeve profesionale të larta mund të transferohen në studimet e ciklit të parë, që referohet në nivelin 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, sipas kriterëve të përcaktuara nga institucionet e arsimit të lartë.

Neni 27

Pranimi dhe procedurat e pranimi në programet e studimeve

1. Pranimi i kandidatëve të rinj për të ndjekur studimet në Kolegjin Profesional të Lartë "Tirana Esthetics & Style School", në ciklin e parë bëhet me konkurs ose test pranimi, përkundrejt tarifës së caktuar. Pranimi organizohet dhe përgatitet nga departamentet.
2. Pranohen për të ndjekur studimet në Kolegjin Profesional të Lartë "Tirana Esthetics & Style School".
 - Shtetasit shqiptarë apo të huaj që kanë mbaruar shkollën e mesme;
 - Studentë të transferuar nga kolegje ose shkolla të tjera të larta të vendit apo të huaja.
3. Periudha e regjistrimeve, modalitetet e zhvillimit të tyre dhe të konkurseve, dokumentacioni dhe rregullat e konkurimit, përcaktohen çdo vit akademik përpara fillimit të procesit të konkurimeve.

Neni 28

Transferimet

Kolegji Profesional i Lartë "Tirana Esthetics & Style School", ofron mundësi për transferimin e studentëve midis programeve të njëjtit cikël brenda kolegjit. Mundësohen gjithashtu transferime nga programe të tjera studimi të kolegjeve ose shkolla të tjera të larta të vendit apo të huaja të të njëjtit cikël.

Pranimi i tyre bëhet kundrejt vlerësimit të krediteve akademike nëpërmjet komisioneve të ngritura nga Departamenti dhe të miratuar nga Rektori sipas rregullave të këtij statuti dhe rregullores së brendshme.

Neni 29

Ndjekja e një programi të dytë studimi të të njëjtit cikël

Individët, që kanë përfunduar një program studimi, kanë të drejtë të ndjekin një program të dytë studimi të të njëjtit cikël. Këta individë duhet të përmbushin kriteret e pranimit nësoj si ata që regjistrohen për herë të parë në këtë program studimi. Procedura për ndjekjen e programit të dytë të të njëjtit cikël përcaktohet me rregullore të veçantë në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi.

Neni 30

Diplomimi

1. Studenti që ka shlyer të gjitha detyrimet e programit të studimit si dhe detyrimet financiare ndaj KPL "Tirana Esthetics & Style School", fiton të drejtën e marrjes së diplomës.
2. Elementët përbërës, forma e diplomës dhe procedurat për regjistrimin hartohen në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë Përgjegjëse për Arsimit. Forma e diplomës, elementët e sigurisë, si dhe elemente të tjera të saj përcaktohen me dokument të veçantë.
3. Diploma plotësohet me shkrim të qartë e me bojë teknike, nënshkruhet nga Përgjegjësi i Departamentit përkatës dhe Rektori dhe vulloset me vulën e KPL "Tirana Esthetics & Style School".
4. Diploma nuk mund të lëshohet dublikatë. Ajo jepet vetëm një herë.
5. Diploma regjistrohet në regjistrin shtetëror të diplomave dhe të çertifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, që mbahet në Qendrën e Shërbimeve të Arsimit.
6. Dorëzimi i diplomave bëhet me ceremoni.

Neni 31

Diplomat

Me përfundimin e studimeve të larta në Kolegjin Profesional të Lartë "Tirana Esthetics & Style School", fitohen diplomatat me këto tituj:



1. Diplomë Profesionale në Estetikë - Program 2 vjecar
 2. Diplomë Profesionale në Make-Up Artist - Program 1 vjecar
 3. Diplomë profesionale Hair Artist - Program 2 vjecar
- Kolegji Profesional i Lartë "Tirana Esthetics & Style School" organizon ceremoninë e dorëzimit të diplomave për çdo program.

Neni 32

Viti akademik dhe organizimi i mësimdhënies

1. Studimet profesionale në KPL "Tirana Esthetics & Style School" zhvillohen më bazë viti akademik. Rektori shpall datën e fillimit të vitit akademik dhe strukturën mësimore.
2. Viti akademik organizohet në 2 semestra me së paku 20 orë mësimi në auditor (leksione, ushtrime, seminare, praktikë) në javë. Ngarkesa javore pasqyrohet në planin mësimor të programit të studimit.
3. Kolegji Profesional të Lartë "Tirana Esthetics & Style School" paraqet çdo fillim viti akademik pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës gjendjen financiare të institucionit, përbërjen e stafit akademik si dhe tarifat e shkollimit për vitin në vazhdim për çdo program studimi

Neni 33

Gjuha e zhvillimit të mësimi

Gjuha bazë në të cilën do të zhvillohet procesi mësimor do të jetë gjuha shqipe. Në raste të lektorëve të ftuar nga vende të tjera gjuha e zhvillimit të leksioneve dhe seminareve do të jetë Anglishtja ose gjuhë të tjera që do të bihet dakort.

KREU IV

PERSONELI I KOLEGJI PROFESIONAL TË LARTË "TIRANA ESTHETICS & STYLE SCHOOL"

Neni 34

Personeli i Kolegjit Profesional të Lartë "Tirana Esthetics & Style School"

1. Personeli i KPL "Tirana Esthetics & Style School" përbëhet nga:
 - a) personeli akademik;
 - b) personel ndihmës mësimor;
 - c) personeli administrativ.
2. Detyrat dhe të drejtat e personelit të KPL "Tirana Esthetics & Style School" përcaktohen në Rregulloren e Brendshme të institucionit si dhe në kontratat individuale të punës në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Neni 35

Personeli Akademik

1. Personeli Akademik kryen veprimtari të mësimdhënies dhe shërbime për zhvillimin e institucionit, konsultim dhe këshillim për studentët dhe detyra administrative. Raportet ndërmjet veprimtarive të ndryshme përcaktohen në Rregulloren e Brendshme dhe në kontratat e punës.
2. Personeli Akademik në Kolegjit TESS sipas rolit dhe veprimtarisë që kryen kategorizohet në: profesorë, docentë dhe lektorë.
3. Niveli i pagave sipas kategorive dhe vendeve të punës përcaktohen nga Bordi i Administrimit

Neni 36

Personeli akademik i ftuar

1. Për të plotësuar nevojat e procesit mësimor KPL "Tirana Esthetics & Style School", me propozim të departamenteve, fton për veprimtari mësimore e kërkimore personel akademik, sipas kërkesave të vendit të punës për periudha semestrale ose njëvjeçare, të përsëritshme.
2. Përzgjedhja e personelit akademik të ftuar bëhet duke kombinuar nevojat e njësive për mësimdhënie me kualifikimin, eksperiencën dhe kompetencat e tyre. Kriteret e detajuara për aktivizimin dhe përzgjedhjen e lektorëve përcaktohen në Rregulloren e Brendshme të KPL "Tirana Esthetics & Style School".
3. Autoritetin e vendimmarrjes për personelin akademik të ftuar e ka Rektorati. Në kontratën e punës përcaktohen detyrimet dhe të drejtat që ka personeli akademik i ftuar.

Neni 37

Personeli akademik me kontratë

Kolegji Profesional i Lartë "Tirana Esthetics & Style School", punëson me kontratë personalitete vendase ose të huaja për periudha të shkurtëra kohe. Ky personel punësohet me vendim të rektoratit në bazë të propozimeve të departamenteve. Kriteret e punësimit përcaktohen në Rregulloren e Brendshme të KPL "Tirana Esthetics & Style School".

Neni 38

Punësimi

1. Zënia e vendeve të punës për personelin bëhet edhe me konkurs, sipas rastit. Kriteret e punësimit për çdo kategori të personelit akademik dhe administrativ përcaktohen në Rregulloren e Brendshme të KPL "Tirana Esthetics & Style School".

2. Kontratat e punës për personelin e KPL "Tirana Esthetics & Style School" nënshkruhen nga Rektori i, KPL "Tirana Esthetics & Style School" sipas kushteve specifike për secilin nga postet, të shprehura në këtë statut dhe rregulloren bashkëngjitur këtij statuti.
3. Të drejtat dhe detyrat e personelit të KPL "Tirana Esthetics & Style School", rregullohen nga legjislacioni në fuqi, përcaktohen në kodin e punës dhe në kontratat individuale.

Neni 39

Kohëzgjatja e punësimit të personelit akademik

1. Personeli akademik, që mban titullin "Profesor", shërben në detyrë deri në moshën 68 vjeç, me përjashtim të rastit kur, me kërkesën e tij, largohet nga detyra. Mbështetur në nevojat e institucionit dhe me pëlqimin e tij, ai mund të shërbejë në detyrë edhe pas moshës së lartpërmendur, përmes kontratave me kohëzgjatje deri në një vit, të përsëritshme.
2. Personeli akademik, që mban titullin "Profesor i asociuar", shërben në detyrë deri në moshën 65 vjeç. Mbështetur mbi nevojat e institucionit dhe me pëlqimin e tij, ai mund të shërbejë në detyrë edhe pas moshës së lartpërmendur, përmes kontratave me kohëzgjatje deri në një vit, të përsëritshme.
3. Personeli akademik i kategorisë "Profesor" mund të shkëputet përkohësisht, për një periudhë maksimale prej pesë vjetësh, për t'u angazhuar në detyra të rëndësishme shtetërore dhe politike. Për periudhën e shkëputjes mund të zëvendësohet nga personel akademik i punësuar me kontratë me afat të caktuar. Pas përfundimit të detyrës, me kërkesë të tij, anëtar i personelit akademik rikthehet në vendin e mëparshëm të punës ose në një vend të barasvlershëm.

Neni 40

Viti akademik sabatik

1. Personeli akademik i kategorisë profesor dhe lektor i Kolegji Profesional i Lartë "Tirana Esthetics & Style School", ka të drejtë që në çdo 7 vjet të kualifikohet, specializohet apo të punojë brenda dhe jashtë vendit në një sektor të fushës së tyre, për një periudhë kohe deri 1 vit. Kjo kohë mund të konsumohet e tëra pa ndërprerje, ose e ndarë në periudha.

2. Marrëdhëniet juridike mes palëve për këtë periudhë përcaktohen në kontratën e punës.

Neni 41

Personeli ndihmës akademik

1. Personeli ndihmës akademik ndahet në personel ndihmës akademik me karakter mësimor dhe me karakter administrativ.
2. Personeli ndihmës akademik me karakter mësimor ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe/ose të kërkimit shkencor. Ai është pjesë e njësisë bazë dhe shërben për mbështetjen e veprimtarive të kësaj të fundit. Në këtë kategori futen laborantët dhe teknikët.
3. Personeli ndihmës akademik me karakter administrativ ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe/ose të kërkimit shkencor dhe/ose të zhvillimit të institucionit në nivel njësie bazë, njësie kryesore ose në nivel institucional. Në këtë kategori bëjnë pjesë personeli i përcaktuar në rregulloren e brendshme.
4. Kriteret e punësimit të personelit ndihmës akademik, me kohë të plotë, propozohen nga njësia së cilës ky personel i shërben, bazuar në nevojat e kësaj të fundit. Konkursi drejtohet nga një komision *ad-hoc*, i përbërë në shumicë nga përfaqësues të njësisë përkatëse, sipas përcaktimeve të rregullores. Në rregullore përcaktohen edhe modalitetet lidhur me përzgjedhjen e personelit ndihmës akademik, aplikimin e masave disiplinore dhe largimin nga detyra.

Neni 42

Personeli administrativ

1. Personeli administrativ kryen veprimtari administrative dhe teknike në ndihmë të procesit mësimor dhe atij kërkimor. Kategoritë e personelit administrativ dhe nivelet e pagave miratohen nga Bordi i Administrimit, sipas legjislacionit në fuqi.
2. Procedurat e punësimit, vlerësimit të punës së personelit administrativ, politikat e motivimit, shpërblimit, zhvillimit e trajnimit të tij, si dhe procedurat për masat disiplinore përcaktohen në rregullore.

Neni 43

Norma mësimore shkencore

Personeli akademik i brendshëm është i detyruar të shërbejë, duke qënë i zënë me punë të paktën deri në kufirin minimal të normës mësimore vjetore. Në rastet kur ndërmjet shkollave të larta shqiptare apo të huaja, ose institucioneve vendase apo të huaja, nënshkruhen marrëveshje për shkëmbim personeli akademik, norma minimale do të shihet në kuadrin e ngarkesë së përgjithshme të stafit perkates.

KREU V SHPËRBLIMET DHE MASAT DISIPLINORE

Neni 44 Shpërblimet

Shpërblimet jepen për kontribut të dallueshëm, cilësi dhe eficiensë në procesin e punës, me propozim të Rektorit dhe miratim të Administratorit të Kolegjit Profesional të Lartë "Tirana Esthetics & Style School"

Neni 45 Masat disiplinore

Masat disiplinore merren ndaj personelit akademik, autoriteteve drejtuese, personelit ndihmës-akademik dhe personelit administrativ në rastet e shkeljes së Kodit të Etikës dhe mos respektimit të Kontratës së Punës.

Llojet e masave disiplinore, procedurat për dhënien e tyre etj, përcaktohen në rregulloren e brendshme të Kolegjit Profesional të Lartë "Tirana Esthetics & Style School" në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës.

Masat disiplinore u jepen edhe studentëve të regjistruar në Kolegjin Profesional të Lartë "Tirana Esthetics & Style School", të cilët nuk respektojnë detyrimet e përcaktuara në këtë statut, shkelin Kodin e Etikës dhe nuk respektojnë parashikimet e Kontratës së Studentit. Masat ndaj studentit jepen me vendim të Këshillit të Etikës.

KREU VI SIGURIMI I CILËSISË NË KOLEGJIN PROFESIONAL "TIRANA ESTHETICS & STYLE SCHOOL"

Neni 46 Sigurimi i Cilësisë

1. Kolegjit Profesional të Lartë "Tirana Esthetics & Style School" ka përgjegjësi për sigurimin e cilësisë në të gjitha strukturat e tij organizative. Për këtë ngrihet Qendra e cilësisë me përgjegjësinë e ngritjes, implementimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të sistemit të cilësisë në KPL "Tirana Esthetics & Style School".

mbështetur në standardet shtetërore të cilësisë si dhe standardet dhe udhëzimet europiane për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë.

2. Qendra e cilësisë, e ngritur pranë Rektoratit, ka për mision strukturimin e proceseve në KPL "Tirana Esthetics & Style School" në përmbushjen e parimeve themelore:
 - Angazhim dhe përgjegjësi të institucionit për sigurimin e cilësisë;
 - Zhvillim dhe përmirësim të programeve të studimit për të plotësuar sa më mirë nevojat e studentëve dhe palëve të interesuar;
 - Sigurim i transparencës dhe përdorim i ekspertizës së jashtme në vlerësimin e sistemit të cilësisë;
 - Inkurajim të një kulture cilësie brenda Kolegji Profesional të Lartë "Tirana Esthetics & Style School";
 - Përcaktim i përgjegjësive në realizimin e proceseve duke përfshirë edhe përgjegjësinë e institucionit në investimin e të ardhurave publike e private;
 - Përmirësim i vazhdueshëm të sistemit të cilësisë;
 - Demonstrim i sistemit të cilësisë si brenda, ashtu edhe jashtë institucionit.
3. Qendra e Cilësisë ka përgjegjësinë e hartimit të rregulloreve të brendshme dhe procedurave të sistemit të cilësisë në zbatim të standardeve europiane për sigurimin e brendshëm të cilësisë.

KREU VII FINANCIMI

Neni 47

Financimi dhe veprimtaria ekonomike

Kolegji Profesional i Lartë "Tirana Esthetics & Style School", është person juridik privat, që financohet nga të ardhurat e tarifave të shkollimit të vëndosura përpara fillimit të regjistrimit të çdo viti akademik si edhe nga aktiviteti praktik që zhvillon ky kolegji në fushën e konsulencës profesionale që përputhet me fushën ku zhvillon edhe aktivitetin akademik. KPL "Tirana Esthetics & Style School" ka të drejtë të krijojë dhe të përdorë të ardhurat që realizon gjatë veprimtarisë së tij në përputhje me rregullat e buxhetit të detajuara në Rregulloren e Brendshme të kolegjit. Po ashtu, gjithëkës tjetër lidhur me veçoritë e zbatimit të rregullave të kontabilitetit e të administrimit të vlerave materiale e monetare, kontrollit dhe auditimit ekonomiko-financiar në KPL "Tirana Esthetics & Style School" përcaktohen me Rregulloren e Brendshme të kolegjit duke ju përmbajtur legjislacionit përkatës.

Neni 48

Kontrolli dhe auditimi



1. Kontrolli dhe auditimi i brendshëm në Kolegji Profesional i Lartë "Tirana Esthetics & Style School", realizohen nga njësia e auditimit të brendshëm, krijimi dhe funksionimi i së cilës do të bëhet në përputhje me aktet e brendshme të institucionit.

2. Kontrolli dhe auditimi i jashtëm në Kolegji Profesional i Lartë "Tirana Esthetics & Style School", kryhen nga auditues të brendshëm ose të jashtëm, të përzgjedhur nga ministria përgjegjëse për arsimin nga lista e përditësuar çdo vit nga Ministria e Financave.

KREU VIII STUDENTET

Neni 49

Të drejtat dhe detyrat e studentëve

Studenti e fiton cilësinë si i tillë me regjistrimin në KPL "Tirana Esthetics & Style School" dhe e humbet atë me marrjen e diplomës ose me përjashtimin nga shkolla.

1. Studenti ka të drejtë:

- Të përfaqësohet në senatin akademik;
- Të kërkojë respektimin e procesit mësimor dhe të procedurave siç parashikohen në këtë Statut dhe Rregulloren e Brendshme;
- Të shprehë opinionet e veta për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik
- Të ndjekë leksione, seminare/ushtime dhe të gjitha veprimtaritë e tjera mësimore të organizuara në përputhje me statusin e tyre;
- Të përdorë mjediset, pajisjet e shkolles si dhe shërbime të tjera që ofrohen për studentët nga institucioni;
- Të organizohet në shoqata studentore jopolitike dhe joekonomike duke ju përmbajtur përcaktimeve të akteve ligjore dhe nënligjore përkatëse;

2. Studenti është i detyruar:

- Të njohë dhe të zbatojë rregullat e hartuar nga KPL "Tirana Esthetics & Style School";
- Të marrë pjesë në veprimtarinë akademike dhe të zbatojë rregulloren e studimeve të kolegjit;
- Të paguajë tarifat e shkollimit si dhe të gjitha detyrimet e tjera financiare të përcaktuara në rregulloren e brendshme të institucionit;
- Të respektojë kodin e etikës të përcaktuar në rregulloren e brendshme të institucionit;
- Të zhvendosë demet materiale që mund t'i shkaktojnë Kolegjit;
- Të tregojë vëmendjen e duhur ndaj të drejtave të personelit dhe të studentëve të tjerë.



Të drejtat dhe detyrat e studentëve jepen më të detajuara në Rregulloren e Brendshme të Kolegjit.

Kolegji Profesional i Lartë "Tirana Esthetics & Style School" nuk mban përgjegjësi për pasojat që mund të rrjedhin nga mosnjohja e tyre.

Neni 50

Këshillat e studentëve

1. Në KPL "Tirana Esthetics & Style School" studentët organizohen nëpër Këshillat e Studentëve, të cilat janë organizime të pavarura, që nuk zhvillojnë aktivitete politike dhe ekonomike. Këshillat promovojnë pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinojnë përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të institucionit, në strukturat mësimore dhe të shërbimeve.
2. Këshillat e studentëve zgjidhen çdo vit nga votat e studentëve dhe mbështeten në legjislacionin në fuqi.
3. Këshillat e Studentëve nuk kanë të drejtë të organizohen në struktura të tjera politike e jopolitike jashtë KPL "Tirana Esthetics & Style School". Modalitetet dhe procedurat për krijimin, organizimin dhe funksionimin e tyre përcaktohen në Rregulloret e Brendshme, të cilat hartohen në përputhje me kërkesat e statutit dhe propozimeve të studentëve.
4. Këshillat e studentëve shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të KPL "Tirana Esthetics & Style School", si për planet e programet e studimeve, rregulloren dhe veprimtaritë mësimore, cilësinë e shërbimeve, të drejtën për të studiuar, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturor, artistike, sportive.
5. Kolegjit Profesional të Lartë "Tirana Esthetics & Style School" mbështet këshillat e studentëve dhe financo veprimtaritë e tyre duke i parashikuar në buxhetin vjetor.

Neni 51

Bursat

1. Kolegjit Profesional të Lartë "Tirana Esthetics & Style School", mund të ofrojë disa lloje bursash studimi si mbështetje ekonomike për kategori të caktuara sociale, si dhe bursa me kriter rezultatet e Maturës Shtetërore / akademike për studentët e shkëlqyer etj. Bursa e studimit mund të jetë e plotë ose e pjesshme.
2. Kriteret, procedura e aplikimit, e akordimit të bursave dhe kushtet e zbatimit të tyre përcaktohen me rregullore të veçantë.

Neni 52



Shpërblimet për studentët

Për të nxitur e përkrahur studentët e shkëlqyer, Kolegji Profesional të Lartë "Tirana Esthetics & Style School" ndjek politika financiare lehtësuese, të cilat konsistojnë në reduktimin e tarifës së shkollimit.

Procedurat dhe kriteret që përdoren për këtë politikë lehtësuese financiare përcaktohen në Rregulloren e Brendshme të KPL "Tirana Esthetics & Style School".

KREU IX

Neni 53

Dokumentacioni i procesit mësimor

1. Kolegji Profesional i Lartë "Tirana Esthetics & Style School", mban në formë të shkruar:
 - a) regjistrin themeltar të studentëve edhe në formë elektronike;
 - b) regjistrin e arritjeve akademike;
 - c) regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave.
2. Regjistri themeltar i studentëve është dokumenti që vërteton regjistrimin e studentëve në një institucion të arsimit të lartë. Çdo student pajiset me një numër unik matrikullimi, që e mban deri në marrjen e diplomës ose certifikatës, i cili pasqyrohet në këtë regjistër. Regjistri themeltar depozitohet në arkivat e shtetit, sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat, ndërsa kopja e njësuar me origjinalin ruhet për gjithë periudhën kohore të ekzistencës së institucionit të arsimit të lartë. Ai plotësohet edhe në formë elektronike.
3. Regjistri i arritjeve akademike është dokumenti që vërteton rezultatet e arritura nga çdo student i regjistruar në institucionin e arsimit të lartë, sipas programeve të studimit. Regjistri i arritjeve akademike depozitohet në arkivat e shtetit, sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat, ndërsa kopja e njësuar me origjinalin ruhet për gjithë periudhën kohore të ekzistencës së institucionit të arsimit të lartë. Ai plotësohet edhe në formë elektronike.
4. Regjistri i lëshimit të diplomave dhe certifikatave është dokumenti që vërteton emetimin e tyre prej institucionit të arsimit të lartë. Institucionet e arsimit të lartë dokumentojnë tërheqjen e diplomës dhe suplementit të diplomës prej secilit student që ka përfunduar me sukses detyrimet akademike dhe ato të tjera institucionale. Regjistri i lëshimit të diplomave dhe certifikatave depozitohet në arkivat e shtetit, sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat, ndërsa kopja e njësuar me



originalin ruhet për gjithë periudhën kohore të ekzistencës së institucionit të arsimit të lartë. Ai plotësohet edhe në formë elektronike.

Neni 54

Baza e të dhënave të studentëve

1. Kolegji Profesional i Lartë "Tirana Esthetics & Style School", ruan të dhënat personale të studentëve duke përfshirë:
 - a) gjeneralitetet;
 - b) numrin e matrikullimit;
 - c) arritjet akademike në vitet përkatëse, si dhe çdo të dhënë tjetër që ka të bëjë me studimet.
2. Të gjitha proceset e ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave personale të studentëve nga Kolegji Profesional i Lartë "Tirana Esthetics & Style School", kryhen bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

KREU X

MARRREDHENIET ME JASHTË

Neni 55

Marrëdhëniet me jashtë

Kolegjit Profesional të Lartë "Tirana Esthetics & Style School" ka të drejtën e vendosjes së marrëdhënieve me shkolla të larta Shqiptare apo të huaja, si edhe me institucione të tjera mësimore apo që ofrojnë shërbime në fushat e mësimdhënies së KPL "Tirana Esthetics & Style School", shqiptare apo të huaja me qëllim bashkëpunimi dhe shkëmbimi të përvojës akademike, profesionale etj.

Kolegjit Profesional të Lartë "Tirana Esthetics & Style School", ka të drejtën e anëtarësimit në shoqata e organizata kombëtare e ndërkombëtare të Arsimit të Lartë. Ai bashkëvepron me organizma joqeveritare Shqiptare apo të huaja që ndihmojnë në zhvillimin e Arsimit të Lartë.

KREU XI

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 56

Vula zyrtare dhe logo.



Kolegjit Profesional të Lartë "Tirana Esthetics & Style School", ka vulën zyrtare dhe logon sipas shtojcës 2 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij statuti.

Neni 57

Të ndryshme

1. Statuti i Kolegjit Profesional të Lartë "Tirana Esthetics & Style School" miratohet dhe ndryshohet me vendim të Senatit Akademik me dy të tretat e votave dhe i dërgohet për aprovim në Ministrinë përgjegjëse për arsimin.
2. Kur Ministri përgjegjës për arsimin nuk shprehet brenda afatit të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi, statuti konsiderohet i miratuar.
3. Të drejtën e interpretimit të këtij Statuti e ka Senati Akademik i KPL "Tirana Esthetics & Style School".
4. Në zbatim të këtij Statuti, dhe të legjislacionit në fuqi, hartohet rregullorja e institucionit, rregulloret e programit të studimit, aktet e tjera të cituara në këtë statut, si dhe akte të tjera në zbatim të legjislacionit për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë, nga organet dhe strukturat përkatëse të KPL "Tirana Esthetics & Style School", sipas kompetenca dhe tagrave të tyre.

Neni 58

Miratimi dhe hyrja në fuqi

Ky statut është miratuar nga Senati Akademik me vendimin nr.1, datë 15/08/2018 dhe hynë në fuqi, pas miratimit nga Ministri përgjegjës për arsimin.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK KPL "TESS"

PROF.DR QIRJAKO MENIKO



TESS | TIRANA ESTHETICS
& STYLE SCHOOL

Shtojca nr. 2
LOGO DHE
VULA

TESS | TIRANA ESTHETICS
& STYLE SCHOOL



Nr. 35 Prot.

Tiranë, më 06.09.2019

Lënda: Për miratimin e disa ndryshimeve në Statutin e Kolegjit Profesional të Lartë TESS

Drejtuar: Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë


Përsëritet,

Gjatë veprimtarisë së vitit 2019-2020 në Kolegjin Profesional të Lartë TESS, u ngrit një grup pune për rishikimin e statutit i cili konkludoi në disa ndryshime. Ndryshimet e propozuara i gjeni në dokumentin bashkëlidhur, bashkë me vendimet përkatëse të Bordit dhe të Senatit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

REKTORI

PROF.DR. QIRJAKO MENIKO



Kolegji Profesional i Lartë TESS

Adresa: Rr "Gjeneral Nikols" Pallati Shushica, Kati i parë

Kontakt: +355694000014

Email: info@tess.al



KRYETARI

PROF. DR. QIRJAKO MENIKO





Neni 4

Pika 2 e nenit 26 ndryshon si më poshtë:

“2. Kolegji Profesional i Lartë “Tirana Esthetics & Style School”, ofron programe studimi me karakter profesional, pas arsimit të mesëm, me 60 ose 120 kredite formimi, referuar nivelit të pestë të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Kohëzgjatja e tyre normale është një ose dy vite akademike dhe në përfundim lëshohet “Diplomë profesionale” në fushën e arsimit të kryer.”

Neni 5

Neni 27, ndryshon si më poshtë:

“Neni 27

Pranimi dhe procedurat e pranimit në programet e studimeve

1. Pranohen për të ndjekur studimet në Kolegjin Profesional të Lartë “Tirana Esthetics & Style School” shtetasit shqiptarë ose të huaj që plotësojnë këto kritere:
 - a. Vërtetojnë me dokument zyrtar përfundimin e Maturës Shtetërore, si edhe zotërimin e dëftesës së pjekurisë ose diplomës përkatëse, që bën të mundur regjistrimin në programin e studimit, sipas legjislacionit në fuqi;
 - b. Kryejnë pagesën e tarifës së caktuar vjetore dhe/ose të plotë sipas kushteve dhe përcaktimeve të kontratës së Studentit;
 - c. Dorëzojnë dokumentet e nevojshme për lidhjen e kontratës;
2. Numri i studentëve të pranuar bazohet në mundësitë reale të çdo Departamenti për një mësim normal dhe brenda standardeve të kërkuara nga Ministria përgjegjëse për arsimin në përputhje me Ligjin Nr.80/2015, datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në aktet nënligjore përkatëse.”

Neni 6

Këto ndryshime hyjnë në fuqi, pas miratimit nga Ministri i MASR dhe reflektohen në statutin e TESS.



Për disa ndryshime ne statutin e KPL TESS miratuar me urdhërin e Ministrit te MASR nr. 512,
Datë 23/08/2018, “Për miratimin e statutit të Kolegjit Profesional të Lartë Tirana Esthetics &
Style School”

Neni 1

Në nenin 11, behen ndryshimet e mëposhtme:

1. Ne fund të pikës 3, shtohet fjalia si më poshtë:

“Anëtarët e Senatit Akademik kanë një mandat katër vjecar”.

2. Ne fund të pikës 4, shtohet fjalia si më poshtë:

“Modalitetet e përzgjedhjes së anëtarëve përcaktohen në rregulloren e institucionit.”

Neni 2

Në nenin 21 shtohet pika 5 si më poshtë:

“Një nga anëtarët e Bordit propozohet nga Senati Akademik. Të gjithë anëtarët emërohen nga Administratori i NLT sh.p.k. Ata duhet të jenë ekspertë të njohur në fusha akademike, menaxheriale, ekonomike dhe juridike. Anëtarët të Bordit nuk mund të jenë anëtarë të Senatit Akademik.”.

Neni 3

Neni 23, ndryshon si më poshtë:

“Neni 23

Struktura administrative

Struktura administrative përfshin seksionet si vijon:

- Sektori i Menaxhimit Financiar;
- Sektori Juridik;
- Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë;
- Sektori i Burimeve Njerëzore dhe i Shërbimeve Mbështetëse (Bibliotekë/Arkivë, Protokoll dhe Zyra e Informacionit);
- Sektorin IT dhe pajisje elektronike (Ngritja dhe mirëmbajtja e sistemit te rrjetave të komunikimit te brendshëm, mirëmbajtja e të gjitha pajisjeve elektronike);
- Sektorin mirëmbajtje dhe shërbime (personeli teknik i mirëmbajtjes së ambienteve, pastrimit, etj)

Kualifikimi dhe eksperiencat që duhet të plotësojë stafi për secilin nga pozicionet e mësipërme do të jepet në manualin e përshkrimit të vendit të punës dhe detyrave të personelit si dhe në kontratën individuale që do të lidhet me secilin prej tyre.”



ORGANIGRAMA E KOLEGJIT PROFESIONAL TESS – TIRANA ESTHETICS & STYLE SCHOOL

